| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti Filozofik |
| Titulli i lëndës: | HISTORI E SISTEMEVE POLITIKE |
| Niveli: | BA |
| Statusi lëndës: | Obligative |
| Viti i studimeve: | Viti I, Sem. I |
| Numri i orëve në javë: | 3 |
| Vlera në kredi – ECTS: | 6 |
| Koha / lokacioni: | sipas orarit nga Fakulteti |
| Mësimdhënësi i lëndës: | Prof. Dr. Bujar DUGOLLI |
| Detajet kontaktuese: | E mail: bujar.dugolli@uni-pr.edu |
| | |
| Përshkrimi i lëndës | Kursi historia e sistemeve politike i përket fushës politiko-historike. Lënda në përgjithësi përmbledh gjithë materien që ndërlidhet me politikat, me sistemet politike dhe sistemet qeverisëse. Fillimisht ofron qasje në njohjen e politikës si koncept dhe përmbajtje me theks të posaçëm determinantëve të saja – fuqia, shteti , pushteti, qeverisja etj. Më pastaj pjesa më e madhe e materies i është përkushtuar - sistemeve politike me theks të veçantë evoluimit të tyre gjatë historisë. Vëmendje i është kushtuar sistemeve politike, monarkike, autoritare, totalitare e fashiste. Pjesë qendrore e sistemeve politike është përmbledhur në sisteme politike bashkëkohore dhe demokratike. Në fund të materies i është kushtuar kujdes edhe të ardhmes dhe trendëve të sistemeve politike bashkëkohore deri te sistemet e ditëve te sotme. |
| Qëllimet e lëndës: | Lënda ofron njohuri themelore dhe qasje bashkëkohore të historisë së sistemeve- politike dhe institucioneve të qeverisjes.<br>Vëmendja do t'u kushtohet:<br>1. Shpjegimeve teorike, sistemeve politike dhe të qeverisjes: nocionit, rolit, rëndësisë dhe strukturës përkatësisht gjithë asaj që ndërlidhet me sistemet politike dhe ato të qeverisjes, sikurse: nocioni dhe bazat e sistemit politik, strategjitë e konkurrencës për pushtet, hapësirën e veprimit politik në qeverisje, funksionet dhe efikasitetin e sistemit të qeverisjes.<br>2. Njohjes së sistemeve politike të demokracisë liberale: nocionit dhe veçorive themelore të tyre, |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | fillet dhe zhvillimin historik, format e qeverisjes, socialdemokracia në sisteme të qeverisjes dhe të arriturat dhe sfidat e qeverisjes së demokracisë liberale.<br>3. Njohjes së sistemeve politike dhe të qeverisjes së demokracive liberale në periudhën e pasluftës së dytë botërore.<br>4. Njohjes së sistemeve politike totalitare dhe autoritare<br>5. Njohjes së sistemeve politike në periudhën e pas luftës së ftohtë etj. | | |
| Rezultatet e pritura të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët:<br>1. Do të kuptojnë drejtë se ç'është sistemi politik.<br>2. Do të kuptojnë zhvillimin e sistemeve politike nga lashtësia deri ne ditët e sotme;<br>3. Do të kuptojnë politikën në dimensionin tjetër.<br>4. Do të krijojë aftësi për të zbërthyer dhe deshifruar aktualitetin politik të kohës – nga prizmi historik.<br>5. Do të zhvilloj tek studentët aftësinë për analiza politike dhe për të zhvilluar pikëpamje të drejta mbi rrjedhat dhe proceset – sistemet politike e të qeverisjes në periudha të caktuara të historisë.<br>6. Do të formoj tek studentët edhe kulturën demokratike mbi bazën e njohjes së përvojave nga historia e sistemeve politike në vende të ndryshme të botes në periudha të caktuara historike. | | |
| | | | |
| Kontributi ne ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
| Aktiviteti | Orë | Ditë/javë | Gjithsej |
| Ligjërata | 3 | 15 javë | 45 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 javë | 15 |
| Punë praktike | 1 | 10 javë | 10 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 0.30 | 10 ditë/javë | 5 |
| Ushtrime në teren | // | // | // |
| Kollokfiume,seminare | 4 | 2 ditë/javë | 8 |
| Detyra të shtëpisë | 2 | 5 ditë | 10 |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 1 | 20 ditë | 20 |
| Përgatitja përfundimtare për provim | 2 | 5 ditë | 10 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,provim final) | 2 | 2 javë | 4 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Projektet,prezantimet ,etj | 1 | 8 ditë | 8 |
| Totali | | | 125:25= 5 ECTS |
| | | | |
| Metodologjia e mësimdhënies: | **Ligjërata Interaktive,** Gjatë ligjëratave studentët do të kenë mundësi debati jo vetëm me rastin e ligjërimit të temës nga ana e mësimdhënësit por edhe gjatë trajtimit të eseve dhe punimeve të tyre. Seminaret apo prezantimet do të punohen individualisht dhe në grupe. Mësimdhënia zhvillohet me ligjërime orale me ndihmën e prezantimeve vizuale, nëpërmjet video-projektorit etj . | | |
| Metodat e vlerësimit: | Vijimi i rregullt, angazhimi në ligjërata 15%<br>Realizimi dhe prezantimi i projekteve 30%<br>Provimi final 55%<br>Totali 100% | | |
| Literatura | | | |
| Literatura bazë: | - Heywood, Andrew. *Politics,* Macmillan Foundations: 1997. Në shqip: *Politika*, Brezi ’81, Prishtinë: 2008<br>- Anastasi, Aurela. *Historia Institucioneve*. Tiranë: 2002<br>- Filo, Llambro. *Sistemet politike bashkëkohore*. Tiranë: 2008<br>- Mayer, C. Lavrence. *Politikat Krahasuese,* kombet dhe teoritë në një botë që ndryshon. Tiranë: 2003<br>- Grup autorësh. Historia e Shtetit dhe e së Drejtës. Shtëpia botuse, “Luarasi”, Tiranë: 2007 | | |
| Literatura shtesë: | - Omari, Luan. *Shteti i së Drejtës*. Tiranë: 2008.<br>- Kosumi, Bajram. *Koncept për mendimin e ri politik*, Prishtinë 2001<br>- Bajrami, Arsim. *Demokracia Parlamentare*. Prishtinë: 2005<br>- Bajrami, Arsim. *Parlamentarizmi*. Prishtinë: 2010. Etj. | | |

| | |
|---|---|
| | |

| Plani i dizajnuar i mësimit: | |
|---|---|
| Java | Ligjërata që do të zhvillohet |
| *Java e parë:* | Njoftimi i studentëve me syllabusin e lëndës detyrat dhe obligimet ndaj lëndës |
| *Java e dytë:* | **Teoritë mbi Politiken dhe Sistemet Politike**<br>*-Përkufizimi i Politikes, Përkufizimi i Sistemit Politik, Studimi i Politikës.* |
| *Java e tretë*: | **Qeveritë, sistemet dhe regjimet**<br>*-Klasifikimi i sistemeve politike, Regjimet e botes moderne.* |
| *Java e katërt:* | **Ideologjitë Politike**<br>*-Ç'është ideologjia politike, Liberalizmi, Konservativizmi, Socializmi, Tradita të tjera Ideologjike.* |
| *Java e pestë:* | **Shteti dhe Demokracia**<br>*-Përkufizimi i demokracisë dhe Shtetit, Modelet e Demokracisë, Teoritë dhe roli i shtetit.* |
| *Java e gjashtë*: | **Institucionet e centralizuara dhe decentralizuara**<br>*-Sistemet Feudale dhe Unitare, Politika etnike dhe komunitare, Te kuptuarit e politikes Botërore.* |
| *Java e shtatë:* | **Sistemet dhe politikat Ekonomik**<br>*Kapitalizmi dhe Socializmi, Strukturat dhe ndarjet shoqërore.* |
| *Java e tetë:* | **Kushtetuta, Ligjet dhe gjyqësori**<br>*-Klasifikimi i kushtetutave, Ligji, moraliteti dhe politika Institucionet gjyqësore.* |
| *Java e nëntë:* | **Institucionet e sigurisë**<br>*-Ushtria dhe roli i sajë, Policia dhe kontrolli civil, Shërbimet e inteligjencës.* |
| *Java e dhjetë:* | **Politika dhe përformanca**<br>*-Procesi politik, Përformanca e sistemit.* |
| *Java e njëmbëdhjetë*: | **Krahasimi i sistemeve politike**<br>*-Periudha Antike, Mesjetare, Moderne dhe Bashkëkohore.* |

| | |
|---|---|
| *Java e dymbëdhjetë*: | **Religjioni dhe Sistemet Politike**<br>*-Ndikimet e feve ne sistemet politike specifike* |
| *Java e trembëdhjetë*: | **Bota bashkëkohore dhe sistemet politike**<br>*-Sistemet politike pas luftës së ftoftë, Ndikimi i faktorëve të rinj në përmirësimin e sistemeve.* |
| *Java e katërmbëdhjetë*: | **Prezantimi dhe diskutimi i Projekteve të realizuara** |
| *Java e pesëmbëdhjetë*: | **Përmbledhje e përgjithshme** |

| Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes*: |
|---|
| • Hyrja me kohë në ligjërata - e domosdoshme.<br>• Vonesa mbi 10 minuta nuk justifikohet;<br>• Telefonat celularë shkyçen para se të fillojë procesi mësimor;<br>• Kopjimi gjatë provimit final - i ndaluar dhe ndëshkohet;<br>• Shfrytëzimi jo i drejtë i burimeve (plagjiati etj.) me rastin e hartimit të eseve, punimeve seminarike etj. i ndaluar dhe ndëshkohet;<br>Çdo kontakt me profesorin e lëndës, lidhur me çështjet që dalin nga lënda përkatëse - nëpërmjet e-mail adresave, ditëve të parapara për konsultime dhe në raste urgjente edhe përmes telefonit.<br><br>** Statuti i Universitetit të Prishtinës i cili është në fuqi parasheh politikat e mirësjelljes dhe misionin e Universitetit.*<br>*Ne do t'i përmbahemi këtij statuti, njëherësh kërkojmë që edhe studentet të jene të përkushtuar në respektimin e aktit më të lartë normativ të Universitetit të Prishtinës.* |

*© Bujar Dugolli, të gjitha të drejtat të rezervuara*